

VENDIM
Nr.129, datë 2.3.2006

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.3.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 123.2 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.205, datë 13.3.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar në fund të pikës 247.1 të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

“Kushti për të pasur një “nevojë reale ekonomike” quhet i plotësuar në njërin prej rasteve të mëposhtme:

a) Mallrat, të cilat kërkohen të vihen në regjimin e magazinës doganore, shërbejnë si burime alternative të energjisë dhe që, për vetë specifikat e transportit, ruajtjes, tregtimit, vëllimit e vlerës së tyre, e kanë të domosdoshme vendosjen në një regjim të magazinimit doganor. Futja e të tilla mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet vetëm nga persona juridikë, të licencuar nga autoritetet përkatëse dhe kërkesa e tyre, për të fituar një autorizim të magazinës doganore, vlerësohet vetëm në rast se historiku i përmbushjes dhe shlyerjes së detyrimeve, tatimore e doganore, nuk përmban shkelje, shmangie, fshehje, penaltete dhe ndëshkime të tjera, në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Në këto mallra përfshihen nafta dhe nënproduktet e saj, si edhe gazi natyror.

b) Mallrat, të cilat kërkohet të vihen në regjimin e magazinës doganore, janë mjete të papërdorura, vetëlëvizëse, që futen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga importues të autorizuar nga prodhuesit a distributorët e këtyre mjeteve dhe që, për vetë numrin e madh të copëve në një dërgesë, për sipërfaqen e madhe, që zënë gjatë parkimit, për kohën e gjatë të shitjes së mjeteve dhe për vlerën e madhe të dërgesës, e kanë të domosdoshme vendosjen në një regjim të magazinimit doganor. Kërkesa e aplikuesit, për të fituar një autorizim të magazinës doganore, vlerësohet vetëm në rast se historiku i përmbushjes dhe shlyerjes së detyrimeve, tatimore e doganore, nuk përmban shkelje, shmangie, fshehje, penaltete dhe ndëshkime të tjera, në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Në këto mallra përfshihen autoveturat, kamionçinat, furgonët, mikrobusët dhe autobusët.

c) Mallrat, të cilat kërkohet të vendosen në regjimin e magazinës doganore, janë mallra, që u nënshtrohen njërit apo disa prej proceseve të mëposhtme:

- ambalazhim apo çambalazhim;
- vendosjes së etiketave, vulave, markave apo shenjave të ngjashme, me kusht që të mos bëjnë që mallrat të duken me origjinë të ndryshme nga origjina e tyre e vërtetë;
- montim apo bashkim i pjesëve, deri në masën që ato të paraqesin një element shtesë dhe jothelbësor në fabrikimin e mallit.

Kërkesa e aplikuesit, për të fituar një autorizim të magazinës doganore, vlerësohet vetëm në rast se historiku i përmbushjes dhe shlyerjes së detyrimeve, tatimore e doganore, nuk përmban shkelje, shmangie, fshehje, penaltete dhe ndëshkime të tjera, në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

ç) Mallrat, të cilat kërkohet të vendosen në regjimin e magazinës doganore janë mallra që, pasi u nënshtrohen një apo më shumë operacioneve, të përshkruara në shkronjën “c” të këtij vendimi, destinohen për shpërndarje të mëtejshme në tregjet rajonale, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe kur këto mallra nuk janë vendosur në regjimin transit. Kërkesa e aplikuesit, për të fituar një autorizim të magazinës doganore, vlerësohet vetëm në rast se historiku i përmbushjes dhe shlyerjes së detyrimeve, tatimore e doganore, nuk përmban shkelje, shmangie, fshehje, penaltete dhe ndëshkime të tjera, në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

d) Në çdo rast, dhënia e autorizimit duhet të shoqërohet me mbulimin me garanci bankare, në masën e përcaktuar në aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi.

dh) Shërbimi doganor detyrohet që, për çdo autorizim për magazinë doganore, të miratuar, të instalojë falas *soft-ware* kompjuterike, me modulet përkatëse. Të gjitha lëvizjet e mallrave dhe të

dokumenteve shoqëruese të pasqyrohen nga subjekti, nëpërmjet sistemit kompjuterik.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha